



Art Arab apo Islam?: Impakti i gjuhës Arabe në artin viziv

Description

Titus Burckhard

Burimi: *Titus Burckhard në Studies in Comparative Religion*, Vol. 5, No. 1 (Winter, 1971). © World Wisdom, Inc.

Shprehja “art Arab” është një prej shprehjeve më të zakonshme për të përcaktuar artin Islam, gjithsesi kjo thënie shpesh herë është paragjykuar dhe kundërshtuar në disa raste duke sjellë argumente që në dukje të parë sjellin një pohim të kundërt të shprehjes dhe sinonimit që ajo sjell . Pyetja e parë që bëhet është se çfarë i karakterizon gjeninë arabe, e si mundi ky gjenialitet të transformohej në art? Duke qenë se i vetmi art i trashëguar nga periudha Para-Islamike Arabe, ishte një kulturë në të shumtën e rasteve nomade me fise që jetonin në një kryqëzim udhësh, ku mbizotëronte një kulturë rektilineare dhe e cila ndërtohej nga esnafë- të cilët gabimisht edhe mund ti nënvlerësojmë, influencat e cilëve më vonë ishte shumë e madhe si në gjuhën e folur ashtu dhe në atë të shkruar. Arabëtlanë trashëgimi gjuhën e tyre gjithë civilizimit Islam, e kjo jo vetëm që ishte një mënyrë për të ruajtur gjuhën arabe, por kjo ishte një shtysë për ta nxjerrë atë nga perceptimi i ngushtë racor. Kjo gjuhë ishte ndërmjetësja kryesore mes çdo gjeniu arab dhe botës Islame.

Fuqia normative dhe e jashtëzakonshme e gjuhës arabe lidhet si me rolin e saj si një gjuhë e shenjtë po ashtu dhe me karakterin arkaik të saj, këto dy aftësi që për më tepër janë të bashkrenduara: ishte arkaizmi që i dha Arabishtes rolin e saj si një gjuhë e shenjtë, e ishte Kurani që në një formë a në një tjetër i dha Arabishtes lashtësinë e saj dhe të qënurit substancë primare. Në kontekstin areal, arkaizmi nuk ka kuptimin e thjeshtësisë strukturore, por është e kundërta: gjuhët zakonisht varfërohen me kalimin e kohës, ata humbasin si diferencimin hierarkik të kuptimit dhe formën llogjike të përcaktimit, ndërsa ndërlikohen nga ana retorike për të kompensuar këtë varfëri. Ajo çka habit më së shumti shkencëtarët e gjuhës është aftësia e arabishtes për të ruajtur morfologjinë e saj e kjo vërehet duke marrë si shembull kodet e Hamurabit që janë shkruar në shekullin e 19 ose 18 p.e.s.[1] dhe kanë ruajtur dhe një sistem fonetik që përjetëson, e që derivohet nga një tingull i vetëm, tingullin më tëpasur dhe më të plotë nga gjithë gjuhët e vjetra Semitike të zbuluara deri më tani,[2] e është ruajtur në këtë formë edhe pse kemi pasur një mungesë totale të traditës letrare e cila mundet të kishte shërbyer si urë lidhëse mes periudhës së Patriarkëve dhe asaj Kuranike për të përcaktuar lidhjet gjuhësore. Shpjegimi i kësaj përhershmërie të gjuhës arabe shtrihet dhe tek roli konservator i nomadëve: është pikërisht në qytete ku degradon gjuha, për vetë faktin se u përshtatet vendeve dhe institucioneve duke humbur kuptimin e saj; ndërsa qëndrimi konservator i nomadëve, përkundrazi, e mbron gjuhën dhe e dërgon atë në shpërthime që ndodhen brënda qenësisë së saj: pjesa e simbolikës që nomadët përdorën më shumë ishte arti i të folurit, i cili nuk ka kufizime vendore, e karakteri i të cilave kufizohet me vetë jetën nomade, ndërkohë që popujt sedentarë zhvillojnë artet plastike, që kërkojnë një stabilitet dhe që simbolika e tyre është e lidhur në mënyrë natyrale me idenë e qëndrës në hapësirë.[3] Mundet të përcaktojmë në terma të përgjithshëm se gjuha Arabe garanton mbijetesën, nga anamendore, tënjë Semitizmi parësor, me karakter nomad.

Për ta shpjeguar në fjalë të pakta, e pa ndihmën e ndonjë dije të veçantë linguistike, se çfarë është kaq specifike dhe e veçantë në këtë gjuhë duhet të dimë se çdo gjuhë përbëhet nga dy rrënjë ose pole, njëri prej të cilëve do të mbizotërojë, e këto pole mund ti paraqesim me termat “intuitë auditive” dhe “intuitë imagjorative”. Kuptimi i termit të parë është ai i të dhënit emër një objekti përmes tingullit të cilit ai kryen; e ky emërtim arrihet në atë moment ose disi më pas, jo përmes kuptimit të onomatopesë, por sepse vetë tingulli është një ngjarje që shtrihet në kohë, e kjo korespondon në formën *a priori* me çdo rregull të gjuhëve semite; të folurit është në thelb një veprim dhe sipas llogjikës, gjuha percepton çdo gjë që emëron si një veprim ose si një objekt i veprimit. Intuita imagjorative, nga ana tjetër, është manifestuar në gjuhë përmes të kuptuarit semantik ose asociimit analog që i bëhet një imazhi: kjo do të thotë se çdo fjalë e shprehur në kontekst të një veprimi të imagjinitiv, e cila ka perceptivë në

Date Created

16/10/2014

Author

erasmusi